

UDHËZIM
Nr. 1, datë 4.3.2015

PËR DISA NDRYSHIME NË MANUALIN “MBI KONTROLLIN TEKNIK TË MJETEVE”

Në mbështetje të pikës 4, neni 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 79 të ligjit nr. 8378, datë 22.7.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenit 234 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 153, datë 7.4.2000 “Për miratimin e rregullores së zbatimit të Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, direktivës 2009/40 EC, datë 6.5.2009 “Mbi kontrollin teknik të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove” dhe nenit 3 të udhëzimit nr. 2, datë 11.3.2010 “Mbi kontrollin teknik të mjeteve rrugore”, ministri i Transportit dhe Infrastrukturës

UDHËZON:

Në manualin “Mbi kontrollin teknik të mjeteve rrugore”, Arsytet për dështim, të kontrollit të sistemit të shkarkimit të gazrave të mjeteve rrugore, ndryshohen si më poshtë vijon:

1. Në kapitullin e parë, artikulli nr. 9 “Gazrat shkarkues – diesel”:

1. Arsytet për dështim:

Nr.	Mjetet rrugore të regjistruara pas 1 janar 1980 deri më 1 korrik 2008	S	K
1.	Treguesit mesatar të matjeve të gazrave të shkarkimit të motorit janë më të larta se 2.5 (+40%) m-1 në rastet e motorëve diesel me aspirim normal dhe 3.0 (+40%) m-1 në rastet e motorëve diesel turbo (të mbiushqyer)	x	
	Mjetet rrugore të regjistruara pas 1 korrik 2008		
2.	Treguesit mesatar të matjeve të gazrave të shkarkimit të motorit janë më të larta se 1.5 +(60%) m-1	x	
	Gazrat e shkarkimit (mjetet rrugore të regjistruara para 1 janar 1980)		
3.	Mbetjet që dalin nga sistemi shkarkues kanë ngjyrë të zeze apo më të errët dhe treguesit mesatar të matjeve të gazrave të shkarkimit të motorit janë më të larta se 4.0 (+20%) m-1	x	
	Sistemi i kontrollit të shkarkimit		
4.	Rrjedh, nuk është i plotë apo është instaluar në mënyrë jo të plotë ose jo të saktë	x	
	Shpejtësia e motorit në gjendje të lirë (minimo)		
5.	Shpejtësia e motorit në gjendje të lirë nuk është korrekte (krahasuar me shpejtësinë që përcakton konstruktori, me një tolerancë +/- 200 rpm)	x	

2. Në kapitullin e parë, artikulli nr. 10 “Sistemi i shkarkimit – benzinë”:

Arsytet për dështim:

Nr.	Sistemi shkarkues i motorit	S	K
1.	Ka rrjedhje	x	
	Sistemi i kontrollit të emetimit		
2.	Sistemi i kontrollit të emetimit ka rrjedhje, është i paplotë apo nuk është instaluar në mënyrë korrekte	x	
	Shpejtësia në gjendje të lirë (minimo)		
3.	Dukshëm mbi nivelin e rekomanduar nga konstruktori	x	
	Emetimi i monoksidit të karbonit		
4.	Për mjetet rrugore të regjistruara përpara 1 tetor 1986, përmbajtja e monoksidit të karbonit është më shumë se 4.5 % (+10%) në gjendje të lirë (minimo)	x	
5.	Për mjetet rrugore të regjistruara pas 1 tetor 1986 dhe deri më 31 dhjetor 1993, përmbajtja e monoksidit të karbonit është më shumë se 3.5 % (+20%) në gjendje të lirë (minimo)	x	
6.	Për mjetet rrugore të regjistruara pas 1 janar 1994, përmbajtja e monoksidit të karbonit është më shumë se 0.5 % (+40%) në gjendje të lirë (minimo)	x	
7.	Për mjetet rrugore të regjistruara pas 1 janar 1994, përmbajtja e monoksidit të karbonit në 2,500 R.P.M. apo në shpejtësinë e rekomanduar nga konstruktori është më shumë se 0.3 % (+40%)	x	
8.	Për mjetet rrugore të regjistruara pas 1 korrik 2002, përmbajtja e monoksidit të karbonit në gjendje të lirë (minimo) është më shumë se 0.3 % (+60%)	x	
9.	Për mjetet rrugore të regjistruara pas 1 korrik 2002, përmbajtja e monoksidit të karbonit në 2,500 R.P.M. apo në shpejtësinë e rekomanduar nga konstruktori është më shumë se 0.2 % (+60%)	x	
	Hidrokarboni (HC)		
10.	Për mjetet rrugore të regjistruara përpara 1 tetor 1986, përmbajtja e hidrokarbonit në minimo është më shumë se 1,000 (+10%) P.P.M.	x	
11.	Për mjetet rrugore të regjistruara nga 1 tetor 1986 deri më 31 dhjetor 1993, përmbajtja e hidrokarbonit në minimo është më shumë se 750 (+20%) P.P.M.	x	
12.	Për mjetet rrugore të regjistruara pas 1 janar 1994, përmbajtja e hidrokarbonit në 2,500 R.P.M. apo në shpejtësinë e rekomanduar nga konstruktori është më shumë se 200 (+40%) P.P.M.	x	
	Lambda		

13.	Për mjetet rrugore të regjistruara pas 1 janar 1994, vlera Lambda në shpejtësinë 2,500 R.P.M. ose në shpejtësinë e rekomanduar nga konstruktori nuk është 1 ± 0.3 (+40% e 0.3) ose është brenda rekomandimeve të konstruktorit të mjetit rrugor	x	
	Sistemi shkarkues i motorit		
14.	Tymrat në sistemin shkarkues të japin të kuptosh që motori harxhon shumë vaj	x	

3. Në kapitullin e dytë, artikulli nr. 9 “Gazrat shkarkues – diezel”:

Arsyet për dështim:

Nr.	Mjetet rrugore të regjistruara më apo pas 1 janar 1980 deri 1 korrik 2008	S	K
1.	Treguesit mesatar të matjeve të gazrave të shkarkimit të motorit janë më të larta se 2.5 (+40%) m-1 në rastet e motorëve diezel me aspirim normal dhe 3.0 (+40%) m-1 në rastet e motorëve diezel turbo (të mbiushqyer)	x	
	Mjetet rrugore të regjistruara pas 1 korrik 2008		
2.	Treguesit mesatar të matjeve të gazrave të shkarkimit të motorit janë më të larta se 1.5 (+60%) m ⁻¹	x	
	Gazrat e shkarkimit (mjetet rrugore të regjistruara para 1 janar 2008)		
3.	Mbetjet që dalin nga sistemi shkarkues kanë ngjyrë të zehtë (blozë) apo më të errët dhe treguesit mesatar të matjeve të gazrave të shkarkimit të motorit janë më të larta se 4.0 (+20%) m-1	x	
	Sistemi i kontrollit të shkarkimit (mbetjeve)		
4.	Rrjedh, nuk është i plotë apo është instaluar në mënyrë jo të plotë ose jo të saktë	x	
	Shpejtësia e motorit në gjendje të lirë "të pangacmuar"		
5.	Shpejtësia e motorit në gjendje të lirë nuk është korrekte (krahasuar me shpejtësinë që përcakton konstruktori, me një tolerancë +/- 200 rpm)	x	

4. Në kapitullin e dytë, artikulli nr. 10 “Sistemi i shkarkimit – benzinë”:

Arsyet për dështim:

Nr.	Sistemi shkarkues i motorit	S	K
1.	Ka rrjedhje	x	
	Sistemi i kontrollit të emetimit		
2.	Sistemi i kontrollit të emetimit ka rrjedhje, është i pa plotë apo nuk është instaluar në mënyrë korrekte	x	
	Shpejtësia në gjendje të lirë (minimo)		
3.	Dukshëm mbi nivelin e rekomanduar nga konstruktori	x	
	Emetimi i monoksidit të karbonit		
4.	Për mjetet rrugore të regjistruara përpara 1 tetor 1986, përmbajtja e monoksidit të karbonit është më shumë se 4.5 % (+10%) në gjendje të lirë (minimo)	x	
5.	Për mjetet rrugore të regjistruara pas 1 tetor 1986 dhe deri më 31 dhjetor 1993, përmbajtja e monoksidit të karbonit është më shumë se 3.5 % (+20%) në gjendje të lirë (minimo)	x	
6.	Për mjetet rrugore të regjistruara pas 1 janar 1994, përmbajtja e monoksidit të karbonit është më shumë se 0.5 % (+40%) në gjendje të lirë (minimo)	x	
7.	Për mjetet rrugore të regjistruara pas 1 janar 1994, përmbajtja e monoksidit të karbonit në 2,500 rpm apo në shpejtësinë e rekomanduar nga konstruktori është më shumë se 0.3 % (+40%)	x	
8.	Për mjetet rrugore të regjistruara pas 1 korrik 2002, përmbajtja e monoksidit të karbonit në gjendje të lirë (minimo) është më shumë se 0.3 % (+60%)	x	
9.	Për mjetet rrugore të regjistruara pas 1 korrik 2002, përmbajtja e monoksidit të karbonit në 2,500 rpm apo në shpejtësinë e rekomanduar nga konstruktori është më shumë se 0.2 % (+60%)	x	
	Hidrokarboni (H.C.)		
10.	Për mjetet rrugore të regjistruara përpara 1 tetor 1986, përmbajtja e hidrokarbonit në minimo është më shumë se 1,000 (+10%) PPM	x	
11.	Për mjetet rrugore të regjistruara nga 1 tetor 1986 deri më 31 dhjetor 1993, përmbajtja e hidrokarbonit në minimo është më shumë se 750 (+20%) PPM	x	
12.	Për mjetet rrugore të regjistruara pas 1 janar 1994, përmbajtja e hidrokarbonit në 2,500 rpm apo në shpejtësinë e rekomanduar nga konstruktori është më shumë se 200 (+40%) PPM	x	
	Lambda		
13.	Për mjetet rrugore të regjistruara pas 1 janar 1994, vlera Lambda në shpejtësinë 2,500 rpm ose në shpejtësinë e rekomanduar nga konstruktori nuk është 1 ± 0.3 (+40% e 0.3) ose është brenda rekomandimeve të konstruktorit të mjetit rrugor	x	
	Sistemi shkarkues i motorit		
14.	Tymrat në sistemin shkarkues të japin të kuptosh që motori harxhon shumë vaj	x	

5. Në kapitullin e tretë, artikulli nr. 108 “Sistemi i shkarkimit benzinë”

Arsyet për dështim:

Nr.	Mbetjet	S	K
1.	CO në shpejtësi "minimo" më shumë se 4.5 % (+40%)	x	

6. Normat e lejuara të shkarkimit të gazrave plus shtesën në kllapa (+ __ %) janë të vlefshme për periudhën 1 korrik deri 31 dhjetor 2015.

7. Normat e lejuara të shkarkimit të gazrave plus $\frac{1}{2}$ (një të dytën) e shtesës në kllapa (+ __ %) janë të vlefshme për periudhën 1 janar deri 30 qershor 2016.

8. Normat e lejuara të shkarkimit të gazrave sipas direktivës 2009/40 EC, datë 06.05.2009, pa shtesën në kllapa (+ __ %), janë të vlefshme për periudhën pas 1 korrik 2016.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I TRANSPORTIT
DHE INFRASTRUKTURËS
Edmond Haxhinasto